D E K R E T
Nr.7451, datë 5.1.1991

PËR DISA NDRYSHIME NË DEKRETIN NR.5105, DATË 30.10.1973 "PËR MBROJTJEN E MJEDISIT NGA NDOTJA"

Neni 1

Në dekretin nr.5105, datë 30.10.1973 "Për mbrojtjen e mjedisit nga ndotja", titulli i tij ndryshohet si vijon:

Dekret " Për ruajtjen dhe mbrojtjen e mjedisit".

Neni 2

Neni 1 ndryshohet si vijon:

"Ruajtja dhe Mbrojtja e Mjedisit (ujit, ajrit dhe tokës) nga ndotja me lëndë të gazta, të lëngëta, të ngurta, radioaktive dhe nga ndotja me mbetje të rrezikshme etj., që krijohen ose shkarkohen nga objektet industriale, bujqësore, komunale, tregtare, socialkulturore, ushtarake dhe mjetet e transportit, si dhe nga veprimtaritë e çfardollojshme që cënojnë ekuilibrin e sistemeve ekologjike natyrore ose dëmtojnë të mirat materiale dhe vlerat kulturore e historike, janë të detyrueshme për të gjitha organet shtetërore, ndërmarrjet, institucionet, kooperativat, organizatat shoqërore, njësitë private të prodhimit ose shërbimit, e të gjithë shtetasit si dhe të personat fizikë a juridikë të huaj".

Neni 3

Në nenin 2, paragrafi i dytë ndryshohet si vijon:

"Kufijtë e lejueshëm të lëndëve ndotëse të gazta, të lëngëta, të ngurta e radioaktive që shkarkohen në ujëra, ajër e tokë, si dhe kufijtë e lejueshëm të lëndëve të dëmshme që përmbahen në mbetjet e rrezikshme, propozohen nga ministritë e institucionet e tjera qendrore duke pasur parasysh normat ndërkombëtare dhe, pasi merret pëlqimi i Ministrisë së Shëndetësisë, miratohet nga Komiteti për Mbrojtjen e Mjedisit".

Neni 4

Në nenin 4 shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

"Personat fizikë ose juridikë vendas ose të huaj që krijojnë ose shkarkojnë mbetje të rrezikëshme, janë të detyruar t'i shëndrojnë ato në mbetje të parrezikëshme. Kur ky shëndrim teknologjikisht, është i pamundshëm ata detyrohen që mbetjet e rrezikëshme t'i grumbullojnë, t'i depozitojnë t'i ruajnë t'i transportojnë dhe t'i sistemojnë në përputhje me rregullat që propozohen nga ministritë e institucionet qendrore përkatëse dhe që miratohen nga Komiteti për Ruajtjen dhe Mbrojtjen e Mjedisit.

Neni 5

Pas nenit 7 shtohet neni 7/a me këtë përmbajtje:

"Ndalohet për çdo qëllim importimi, depozitimi dhe asgjesimi i mbetjeve të rrezikshme në territorin e Republikës së Shqipërisë".

Lista e lëndëve që përmbajnë mbetje të rrezikëshme caktohet nga Komiteti për Ruajtjen dhe Mbrojtjen e Mjedisit në përputhje me normat ndërkombëtare.

Neni 6

Në nenin 8 bëhen këto ndryshime:

- Paragrafi i parë dhe shkronja "a" ndryshohen si vijon:

"Inspektorati për Ruajtjen dhe Mbrojtjen e Mjedisit ushtron kontroll mbi ministritë dhe institucionet e tjera qendrore, komitetet ekzekutive të këshillave popullorë të rretheve e të rajoneve, ndërmarrjet, institucionet e kooperativat organizatat shoqërore, njësitë private të prodhimit e shërbimit, personat fizikë a juridikë vendas a të huaj dhe ka këto të drejta:

a) Jep pëlqimin për projektidetë dhe për fillimin e zbatimit të projekteve të objekteve që krijojnë ose shkarkojnë lëndë ndotëse të gazta, të ngurta, të lëngëta e mbetje të rrezikshme.

b) jep qëllimin për projektidetë dhe fillimin e zbatimit të projekteve të objekteve që cënojnë ekologjikisht pyjet dhe zabelet, parqet e rezervatet natyrore kombëtare, lumenjtë, liqejtë, pllajat e kullotat alpine, bregdetin dhe detin.

Pika ekzekutuese “b” bëhet “c”; pika “c” bëhet “e” dhe pika “ç” bëhet “d”.

- Paragrafi i fundit ndryshohet si vijon:

"Detyrat e inspektoratit për ruajtjen dhe mbrojtjen e mjedisit në rrethe dhe rajone kryhen nga inspektorët e ruajtjes e të mbrojtjes së mjedisit pranë komiteteve ekzekutive të këshillave popullore përkatës.

Neni 7

Neni 9 ndryshohet si vijon:

"Për shkeljen e dispozitave të këtij dekreti, kur nuk formon vepër penale, personat fajtorë dënohen për kundëvajtje administrative me gjobë nga 100 deri në 1000 lekë nga inspektorët e ruajtjes e të mbrojtjes së mjedisit në Komitetin për Ruajtjen dhe Mbrojtjen e Mjedisit, dhe 50 deri në 500 lekë nga inspektorët e ruajtjes dhe mbrojtjes së mjedisit në rrethe dhe rajone.

Kundër vendimit të dënimit mund të bëhet ankim brenda 5 ditëve nga shpallja e vendimit ose e njoftimit të tij, përkatësisht tek Kryetari i Komitetit për Ruajtjen dhe Mbrojtjen e Mjedisit.

Gjoba likuidohet në bankë për llogari të Komitetit për Ruajtjen dhe Mbrojtjen e Mjedisit brenda 15 ditëve nga mbarimi i afatit të ankimit. Për çdo ditë vonesë pas plotësimit të këtij afati, gjoba shtohet 10 për qind mbi vleftën e gjobës së vendosur.

Neni 8

Në nenin 10, paragrafi i dytë ndryshohet si vijon:

"Ministritë e institucionet e tjera qendrore, në bashkëpunim me Komitetin për Ruajtjen e Mbrojtjen e Mjedisit, autorizohen të nxjerrin rregulla te detyrueshme për zbatimin e këtij dekreti".